



European  
Union  
Kosovo

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT

## Edukimi për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla

*(Viti shkollor 2018/2019 - 2019/2020)*



**Ky projekt i financuar nga BE-ja implementohet nga "Qendra për Studime të Avancuara FIT" dhe menaxhohet nga:**



"Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e **CIPOF - Childproof NGO** dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian."



## **PLANI LOKAL I VEPRIMIT**

**Edukimi për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla**

**( Viti shkollor 2018/2019 – 2019/2020)**

Korrik, 2018

**Shkurtesat:**

**AP** - Aktivat profesionale

**DKA** - Drejtoria Komunale e Arsimit

**KDSH** - Këshilli Drejtues i shkollës

**KEC** - Qendra për Arsim e Kosovës

**MASHT** - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë

**QRK** - Qeveria e Republikës së Kosovës

**SHFMU** - Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët

**ZHPM** - Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

## I. Hyrje

Ideja për hartimin e Planit të Veprimit Edukimi për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla, lindi nga Childproof/CIPOF dhe mbështetur nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe Forumi ZFD, në kuadër të projektit “Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijës”. Me këtë plan të veprimit synohen të përkrahen shkollat partnere në Komunën e Klinës për përmirësimin e praktikave të parandalimit dhe trajtimit të konflikteve të fëmijëve/nxënësve në shkollë, përmes krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm për trajtimin e konflikteve dhe krijimit të klimës miqësore në shkolla.

Shkollat partnere në Komunën e Klinës të përfshira në programin e mbështetjes për zgjidhje paqësore të konflikteve, janë:

1. SHFMU “Dëshmoret e Qëndreses”, në Gllarevë;
1. SHFMU “Azem Bejta” në Grabanicë;
2. SHFMU “Esat Mekuli” në Cerovikë; dhe
3. SHFMU “Atë Shtifen Gjegovi” në Zllakuqan.

Shkollat partnere në kuadër të programit dhe mbështetjes nga Childproof/CIPOF, janë pajtuar që të hartojnë një plan të veprimit të përbashkët për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla, i cili do të realizohet në bazë të specifikave të secilës shkollë dhe në vazhdimësi të mësojnë së bashku përmes shkëmbimit reciprok të përvojave dhe praktikave të mira në këtë fushë të veprimit.

Procesi i planifikimit për hartimin e Planit të Veprimit *Edukimi për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla*, i realizuar në periudhën Maj-Korrik 2018, është drejtuar nga Grupi për Planifikim i shkollave partnere, me përfshirje të drjetorëve të shkollave, mësimehënësve, nxënësve dhe përfaqësuesve të OJQ-ve që bashkëpunojnë me shkollat partnere në këtë program, ndërsa është realizuar me mbështetje nga DKA dhe konsulenti i angazhuar Childproof/CIPOF. I gjithë procesi u zhvillua në katër faza kryesore: (i) Përcaktimi i fushave për analizë të gjendjes; (ii) Analiza e gjendjes; (iii) Përcaktimi i objektivave dhe aktiviteteve të planit të veprimit; dhe (iv) Hartimi i Plani i veprimit.

Plani veprimit *Edukimi për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla*, mbulon periudhën e dy viteve shkollore 2018/2019 dhe 2019/2020.

### **1.1. Konteksti i parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar**

Parandalimi dhe referimi e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, është një nga prioritetet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), i reflektuar në vitet e fundit në disa dokumentet ligjore, rregullore dhe udhëzues, që kanë referencë Konventën për të drejtat e fëmijës dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut. Disa nga dokumentet dhe udhëzuesit e zhvilluar në vitet e fundit, janë si në vijim:

- **Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK)- nr. 21/2013 për Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar. Qëllimi dhe fushëveprimi i Protokollit: 1.1.** Përcakton detyrimet, qartëson rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit para-universitar; **1.2.**Përforcon bashkëpunimin ndërinstitucional dhe multidisiplinar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për tu mbrojtur fëmijët nga dhuna.
- **Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores së QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar<sup>1</sup>.** Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është që me anë të udhëzimeve dhe aktiviteteve specifike, të ndihmojë institucionet përgjegjëse në zbatimin e protokollit. Udhëzuesi ofron alternative të përballjes me “dhunën” në mënyrë pozitive dhe proactive, duke parandaluar sjelljen e keqe përpara se ajo të ndodhë, duke u marrë në mënyrë efektive me sfidat e paparashikuara, si dhe orjentimin e përpjekjeve institucionale në ngritjen e cilësisë në arsim.
- **Doracaku për parandalimin e dukurive negative në shkolla të mesme të larta<sup>2</sup>.** Qëllimi i këtij doracaku është parandalimi i dukurive negative në shkolla të mesme të larta nëpërmjet procesit të rregullt edukativo-arsimor. Me zbatimin efikas të doracakut, mësimsdhënësit mund të rrisin performancën e tyre të mësimsdhënies dhe mësimsnxënies, në vetëdijësimin mbi trajtimin adekuat të problemeve me të cilat ballafaqohen brenda shkollave, duke kultivuar dhe promovuar te nxënësit vlerat e qytetërimit, sjelljet e shëndosha, shmangien e situatave konfliktuoze si dhe reflektimin e edukatës dhe mirësjelljes adekuate, si në klasë e shkollë, ashtu edhe jashtë: në rrugë, familje dhe shoqëri.
- **Doracaku për ekipet ndërmjetësuese mes bashkëmohatarëve<sup>3</sup>.** Qëllimi i këtij doracaku është të ofrojë një udhërrëfyes fillestar për ndërmjetësimin, trajnimin dhe përgatitjen e Ekipeve për ndërmjetësim mes bashkëmohatarëve për të ndihmuar që kontestet e tyre t’i zgjidhin në mënyrë paqësore, duke përdorur metoda të ndryshme të ndërmjetësimit dhe shkathtësive të komunikimit.
- **Manuali didaktik për parandalimin e dhunës<sup>4</sup>.** Qëllimi i këtij Manuali është parandalimi i dhunës në shkolla nëpërmjet procesit të rregullt edukativo-arsimor, në arsimin e obliguar (1-9) parauniversitar. Manuali didaktik për parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar është një hap i mirë në drejtim të zbatimit të Protokollit 21/2013.

<sup>1</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës - Zyra për qeverisje të mirë (2015).

<sup>2</sup> MASHT (2014) (Me përkrahje nga UNICEF).

<sup>3</sup> UNICEF & KEC (2015).

<sup>4</sup> Save the Children (2014).

## II. Analiza e gjendjes

Analiza e gjendjes mbështetet në të dhënat e ofruara nga katër shkollat partnere, në procesin e konsultimeve që janë realizuar përmes takimeve të veçanta në secilën shkollë, punëtorisë së përbashkët të realizuar me përfaqësuesit e shkollave me 4 qershor 2018, si dhe gjetjeve nga pyetësi i realizuar me përfaqësues të shkollave, lidhur me situatën në trajtimin e rasteve të konflikteve në shkolla, nevojat dhe kërkesat e shkollave dhe parandalimin e dhunës në shkolla. Në konsultim me shkollat partnere, u arrit pajtimi që analiza e gjendjes dhe plani i veprimit të organizohet në katër fusha tematike:

1. Mekanizmat për trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë;
2. Informimi dhe ndërgjegjësimi;
3. Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konflikteve në shkollë;
4. Kapacitetet për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla;

### 2.1. Mekanizmat për trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë

Në kuadër të kësaj fushe tematike, janë analizuar rregulloret e shkollave për trajtimin e rasteve të dhunës në shkolla, si dhe funksionimi i mekanizmave ekzistues në shkolla për trajtimin e rasteve të dhunës/konflikteve në shkolla. Analiza e gjendjes në këtë fushë tregon se shkollat kanë rregulloret e tyre, mirëpo mënyra e rregullimit të trajtimit të rasteve të dhunës nuk është e mbështetur në dokumentet e fundit të zhvilluara nga MASHT për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucione arsimore.

Mungesa e një plani konkret për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla, mosrespektimi i detyrave dhe përgjegjësi nga të gjithë akterët që kanë rol në këtë fushë, moszbatimi i planeve për aktivitete ekstrakurrikulare, përkrahja e pamjaftueshme e menaxhmentit të shkollës për funksionalizimin e plotë të ekipeve për adresim të rasteve të konflikteve në shkolla, janë ndër sfidat kryesore për trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë, që meritojnë vëmendje të veçantë në adresimin e tyre.

Një aspekt tjetër i shrytuar në kuadër të kësaj fushe tematike, është funksionimi i Këshillit të nxënësve dhe Ekipit për ndërmjetësimin e konflikteve. Shkollat partnere i kanë themeluar Këshillat e Nxënësve, mirëpo funksionimi i tyre në masë të madhe është i sfiduar. Ndërsa, ekipet për ndërmjetësimin e konflikteve në shkolla, janë në themelim e sipër dhe sapo kanë filluar se vepruari. Mbetet sfida funksionalizimi i tyre i plotë dhe qendrueshmeria e funksionimit të tyre.

### 2.2. Informimi dhe ndërgjegjësimi

Nderë parimet bazë për ndërmjetësimin e konflikteve janë informimi dhe ndërgjegjësimi i të gjitha palëve që përfaqësojnë komunitetin arsimor në shkollë dhe kanë përgjegjësi në parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të konflikteve në shkollë.

Analiza e gjendjes në këtë fushë tregon se shkollat me mbështetje nga Childproof/CIPOF kanë filluar të organizojnë takime me nxënës, prindër dhe stafin e shkollës, lidhur me rolin e tyre në ndërmjetësimin e konflikteve dhe formimin e ekipit të ndërmjetësimit në nivel shkollë. Gjithashtu, shkollat partnere prezantojnë iniciativa të bashkëpunimit me qëndren rinore, OJQ dhe grupe të tjera jo formale për ndërgjegjësim kundra konflikteve në shkollë.

Gjithsesi, informimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit të shkollës, është sfidë në vete pavarësisht disa iniciativave të mira, kjo reflektohet në mungesë të planeve konkrete për ndërgjegjësim të komunitetit arsimor për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkollë, mungesë të informimit për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkollë, mungesë të pranisë së psikologut në të gjitha shkollat e komunës, por edhe mospërfshirje e të gjithë nxënësve në aktivitetet jashtëshkollore që do të ndihmonin socializimin dhe përfshirjen aktive të tyre në proceset e të nxënësve dhe që do të ndikonin në minimizimin e rasteve të konflikteve ndërmjet nxënësve.

### **2.3. Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konflikteve në shkollë**

Edhe pse pothuajse të gjitha shkollat raportojnë përpjekje për praktika të mira në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë, fillim të suksesshëm në krijimin e grupeve për parandalimin e konflikteve dhe dhunës, ndërmarrjen e disa masave preventive, sfidë kryesore mbetet parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konflikteve në shkollë.

Parandalimi dhe trajtimi i suksesshëm i rasteve të konflikteve në shkollë, në masë të madhe është sfiduar pasi që në shkollë nuk punohet mjaftueshëm në funksionalizimin e ekipeve për zgjedhjen e konflikteve nga nxënësit, komunikim i pamjaftueshëm mesimdhënës - nxënës - prindër dhe anasjelltas, veçanërisht me viktimat të rasteve të konflikteve, mungesë të sesioneve të këshillimit me psikolog të shkollës, mospërfshirje e të gjithë nxënësve në aktivitete jashtëkurrikulare; mospërkrahje të nxënësve me nevoja të veçanta dhe nxënësve talentë, përdorim në disa raste të formave të etiketimit të sjelljes së nxënësve në bazë të suksesit, etj. Në anën tjetër, mospërkrahja e insitucioneve që kanë përgjegjësi për trajtimin e rasteve të konflikteve të nxënësve në shkollë, mungesa e seriozitetit për krijimin e këshillit lokal të nxënësve për parandalimin e konflikteve, vazhdimi i mungesës së bashkëpunimit të shkollës me prindër, keqperdorimi i rrjeteve sociale, telefonave dhe formave të tjera të komunikimit ndërmjet nxënësve, shihen si rreziqe potenciale që mund të pengojnë parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë.



## 2.4. Kapacitetet për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla

Shkollat partnere në programin e mbështetjes nga Childproof/CIPOF, raportojnë përpjekjet e para të tyre në ngritjen e kapaciteteve për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkollë, prioritizim të ngritjes së kapaciteteve në këtë fushë dhe përfshirjen e aktiviteteve në planin e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve (ZHPM).

Pavarësisht iniciativave të mira në ngritjen e kapaciteteve për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla, mospërfshirja e gjithë personelit në trajnime, mosshfrytëzimi i mjaftueshëm i resurseve të brendshme të shkollës, mungesa e trajtimit të gjitha rasteve të konflikteve dhe dhunës në shkolla; mungesa e përvojës për ndërmjeteësim në rastet e konflikteve, moszbatimi i plotë i Planit për ZHPM, sfidojnë në masë të madhe ngritjen e kapaciteteve për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla. Gjithashtu, mungesa e buxhetit për trajnimin e të gjithë mësimitdhënësve në këtë fushë, hezitimi i mësimitdhënësve për të marrë pjesë në trajnime, moszbatimi i protokollit për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkolla, moszbatimi i sistemit të licencimit të mësimitdhënësve, shihen si rreziqe potenciale që mund të pengojnë zhvillimin e kapaciteteve për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla.

## III. Objektivat e Planit Lokal të Veprimit

Plani Lokal i Veprimit *Edukimi për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla*, ka katër objektiva të synuara për ti arritur në periudhën dyvjeçare, nga një për secilën fushë të veprimit, siç është prezantuar në pjesën në vijim.

	Fusha e veprimit	Objektivat e Planit të Veprimit
1	Mekanizmat për trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë	Ndërtimi i mekanizmave efektivë për trajtimin e rasteve të konflikteve në shkolla
2	Informimi dhe ndërgjegjësimi	Ngritja e vetëdijës së komunitetit arsimor për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla
3	Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konflikteve në shkollë	Përmirësimi i praktikave dhe masave edukative për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë
4	Kapacitetet për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla	Ngritja e kapaciteteve të mësimitdhënësve, nënësve dhe stafit tjetër të shkollës për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla

### 3.1. Aktivitet sipas objektivave të Planit të Veprimit

#### 1. Fusha e veprimit: Mekanizmat për trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë

**Objektivi:** *Ndërtimi i mekanizmave efektivë për trajtimin e rasteve të konflikteve në shkolla*

Në këtë fushë të veprimit, përqendrimi i shkollave partnere do të jetë rishikimi i rregulloreve të shkollave, si dhe funksionalizimi i ekipit ndërmjetësues për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve në shkolla. Aktivitetet e përcaktuara për arritjen e objektivit në këtë fushë të veprimit, janë si në vijim:

- *Hartimi/rishikimi i rregulloreve të shkollave, me fokus parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve;*
- *Formimi i ekipit ndërmjetësues në nivel komunal dhe në nivel shkolle për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve në shkolla;*
- *Rishikimi i kriterëve dhe rregullave për hapjen e kutisë së ankesave dhe parashtesave në nivel shkolle;*
- *Vendosja/rivendosja e kutisë në shkollë, për të drejtat e fëmijës/ kutia e ankesave dhe parashtesave;*
- *Monitorimi i zbatimit të rregulloreve të shkollave.*

#### 2. Fusha e veprimit: Informimi dhe ndërgjegjësimi

**Objektivi:** *Ngritja e vetëdijës së komunitetit arsimor për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla*

Në fushën e dytë të veprimit, përqendrimi i shkollave partnere do të jetë në organizimin e aktiviteteve dhe formave të ndryshme të informimit që do të ndikojnë në ngritjen e vetëdijës së komunitetit arsimor të shkollave për zgjidhje paqës

ore të konflikteve. Aktivitetet e përcaktuara për arritjen e objektivit në këtë fushë të veprimit, janë si në vijim:

- *Përgatitja e broshurave dhe letrave informative për rolin e nxënësve për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mes vete nëpërmjet ndërmjetësimit jo formal nga bashkëmoshtarët;*
- *Takime, punëtori, ligjerata, tryeza të rrumbullakta periodike me nxënës, mësues, prindër, pedagogë, psikologë dhe punonjës tjerë sociale, për tematika të ndryshme ( raste të suksesshme të ndërmjetësimit të konflikteve, format e identifikimit të rasteve, masat e parandalimit, etj.);*
- *Organizimi i fushatave me karakter të ndërgjegjëses dhe koordinues për parandalimin e konflikteve në shkolla dhe zgjidhje paqësore të tyre;*
- *Hapja e linkut të uebfaqës së shkollës dhe prezantimi i praktikave të mira të punës së shkollës;*
- *Pjesëmarrja në takimet bashkëpunuese me OJQ dhe grupe të rinjëve (joformale).*

**Fusha e veprimit:** Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konflikteve në shkollë

**Objektivi:** *Përmirësimi i praktikave dhe masave edukative për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë*

Në këtë fushë të veprimit, përqendrimi i shkollave partnere do të jetë ndërmarrja e veprimeve dhe masave edukative që përmirësojnë sjelljet e fëmijëve, promovojnë sjelljet e

mira dhe parandalojnë rastet e konflikteve në shkollë dhe për rreth saj. Aktivitetet e përcaktuara për arritjen e objektivit në këtë fushë të veprimit, janë si në vijim:

- *Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve jashkurrikulare në shkolla, si: ligjerta, debate, aktivitetet artistike me temë kundër dhunës, etj;*
- *Bashkëpunimi me Këshillin e prindërve (KP) dhe Këshillin e nxënësve (KN) në iniciativa dhe veprime konkrete për parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës në shkollë;*
- *Kontrollimi i nxënësve për shmangien e mbajtjes së armëve dhe mjeteve të ndryshme të dhunës;*
- *Identifikimi dhe raportimi i fëmijëve/ nxënësve në rrezik për të shfaqur sjellje të dhunshme;*
- *Evidentimi, raportimi dhe trajtimi i rasteve me sjellje të dhunshme;*
- *Këshillimi individual me nxënësit që kanë bërë konflikte apo sjellje agresive dhe me nxënës që kanë qenë viktime të konflikteve;*
- *Këshillimi me prindër dhe mësimdhënës;*
- *Vendosja e bashkëpunimit të organeve profesionale dhe udhëheqëse të shkollës, me institucionet komunale, organizata joqeveritare që merren me mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve për raste të ndryshme dhe që zhvillojnë programe kundër dhunës në shkolla;*

**Fusha e veprimit:** Kapacitetet për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla

**Objektivi:** Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit tjetër të shkollës për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla

Ngritja e kapaciteteve për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë, është një ndër parakushtet më të rëndësishme për të siguruar zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla. Qëllimi është që ky proces të jetë i vazhdueshëm, në nivel shkolle dhe në mesin e rrjetit të shkollave partnere në këtë program. Aktivitetet e përcaktuara për arritjen e objektivit në këtë fushë të veprimit, janë si në vijim:

- *Hartimi i planit për Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve (ZHPM) në nivel shkolle;*
- *Hartimi i planit për ZHPM në nivel komune;*
- *Zhvillimi/Sigurimi i materialeve për ndihmë mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe aktorëve të tjerë;*
- *Organizimi i trajnimeve në nivel komunal;*
- *Organizimi i trajnimeve në nivel shkolle dhe i formave të tjera të ngritjes profesionale;*
- *Krijimi i rrjetit të ekipeve të ndërmjetësimit në shkolla për shkëmbimin e përvojave pozitive;*

# **PLANI I VEPRIMIT**

**(Viti shkollor 2018/2019 & 2019/2020)**

## Plani i veprimt: Edukimi për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkollë

**1. Fusha e veprimt:** Mekanizmat për trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë

**Objektivi:** Ndërtimi i mekanizmave efektivë për trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë

Aktivitetet	Bartës/ përgjegjës	Afatet kohore	Burimet/ Mjetet e nevojshme	Mënyra e verifikimit/ dokumenti
1.1. Hartimi/rishikimi i rregulloreve të shkollave, me fokus parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve	Drejtori i shkollës dhe KDSH	Në fund të çdo viti shkollor, duke filluar nga gusht 2018	- Protokoli dhe udhëzuesi për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkollë - Rregullorja e shkollës - Rregullorja e DKA-s për arsim	- Procesverbalet e takimeve - Lista e pjesëmarrjes - Raporti i punës - Rregulloret e shkollave të miratuara
1.2. Formimi i ekipit ndërmjetësues në nivel komunal dhe në nivel shkollë për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë	DKA dhe drejtorët e shkollave	Shtator – tetor 2018	- Protokoli dhe udhëzuesi për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkollë	- Procesverbalet e takimeve - Lista e pjesëmarrjes - Vendimi për formimin e ekipit në nivel komunal - Vendimi për formimin e ekipit në nivel shkollë
1.3. Rishikimi i kriterëve dhe rregullave për hapjen e kutisë së ankesave dhe parashtesave në nivel shkollë	Drejtori dhe komisioni i formua nga KDSH	Gusht-shtator 2018	- Protokoli dhe udhëzuesi për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkollë - Rregullorja e shkollës - Rregullorja e DKA-s për arsim	- Procesverbalet e takimeve - Lista e pjesëmarrjes - Raporti i punës me kriteret të përcaktuar;
1.4. Vendosja/rivendosja e kutisë në shkollë, për të drejtat e fëmijës/ kutia e ankesave dhe parashtesave	Komisioni i shkollës	Në fillim të çdo viti shkollor, duke filluar në shtator 2018	- Mjete teknike - Kutia e përgatitur	- Kutia e vendosur, Foto - Raportet e shyrimit të ankesave dhe parashtesave;
1.5. Monitorimi i zbatimit të rregulloreve të shkollave	DKA – zyrtari përgjegjës	Në mënyrë të vazhdueshmë, duke filluar nga shtator 2018	- Rregullorja e shkollës - Rregullorja e DKA-s për arsim - Instrumentet e monitorimit,	- Njoftimet për takime - Agjandat e takimeve - Listat e pjesëmarrjes - Raportet e monitorimit

## 2. Fusha e veprimtimit: Informimi dhe ndërgjegjësimi

**Objektivi:** Ngrija e vetëdijës së komunitetit arsimor për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla

Aktivitetet	Bartës/ përgjegjës	Afatet kohore	Burimet/ Mjetet e nevojshme	Mënyra e verifikimit/ dokumenti
2.1. Përgatitja e broshurave dhe letrave informative për rolin e nxënësve për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mes vete nëpërmjet ndërmjetësimit jo formal nga bashkëmoshtarët	Drejtori dhe udhëheqësi i ekipit të ndërmjetësimit	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Protokoli dhe udhëzuesi për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkolla</li> <li>- Marrëveshja me radio lokale</li> <li>- Laptop, projektor,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Broshura</li> <li>- Fletëpalosje</li> <li>- Inqizime në radio lokale</li> <li>- Foto</li> </ul>
2.2. Takime, punëtori, ligjerata, tryeza të rrumbullakta periodike me nxënës, mësimdhënë, prindër, pedagogë, psikologë dhe punonjës tjerë sociale, për tematika të ndryshme (raste të sukseshme të ndërmjetësimit të konflikteve, format e identifikimit të rasteve, masat e parandalimit, etj.)	Drejtori dhe udhëheqësi i ekipit të ndërmjetësimit	Së paku një tak në tre muaj, duke filluar nga shtatori 2018	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Protokoli dhe udhëzuesi për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkolla</li> <li>- Laptop, projektor, fleta A4, salla për takime</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njoftimet për takime</li> <li>- Agjendat dhe programet e takimeve</li> <li>- Listat e pjesëmarrjes</li> <li>- Foto</li> <li>- Raportet</li> <li>- Pyetësor</li> </ul>
2.3. Organizimi i fushatave me karakter të ndërgjegjësues dhe koordinues për parandalimin e konflikteve në shkolla dhe zgjidhje paqësore të tyre	Drejtori dhe udhëheqësi i ekipit të ndërmjetësimit	Mars – prill 2019 dhe 2020	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Protokoli dhe udhëzuesi për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkolla</li> <li>- Mjete teknike</li> <li>- Personel për organizim të fushatave</li> <li>- Mjete financiare,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Projekti për fushata</li> <li>- Procesverbale të takimeve</li> <li>- Lista e pjesëmarrjes</li> <li>- Broshura</li> <li>- Fletëpalosje</li> </ul>
2.4. Hapja e linkut të uebfaqës së shkollës	Drejtori dhe mësimdhënësi i TIK-ut	Shtatori – tetori 2018	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Internet</li> <li>- Pajisje të TIK-ut</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Uebfaqja e shkollës</li> <li>- Raporti i funksionimit</li> </ul>
2.5. Pjesëmarrja në takimet bashkëpunuese me OJQ dhe grupe të rinjve (joformale)	Ekipi i ndërmjetësimit	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Memorandum/marrëveshje të bashkëpunimit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ftesa dhe agjenda e takimeve</li> <li>- Lista e pjesëmarrjes</li> <li>- Raporte nga takimet;</li> <li>- Foto</li> </ul>

### 3.Fusha e veprimt: Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konflikteve në shkollë

#### Objekti: Përmirësimi i praktikave dhe masave edukative për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të konflikteve në shkollë

Aktivitetet	Bartës / përgjegjës	Afatet kohore	Burimet/ Mjetet e nevojshme	Mënyra e verifikimit/ dokumenti
3.1. Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve jashkurrikulare në shkollë, si: ligjerta, debate, aktivitete artistike me temë kundër dhunës, etj.	Kryetarët e aktiave profesionale	Në fillim të çdo vitit shkollor	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Planet dhe programet mësimore</li> <li>- Udhëzues dhe manual për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkollë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lista e pjesëmarrësve,</li> <li>- Procesverbalet</li> <li>- Planet dhe programet për aktivitete jashkurrikulare</li> <li>- Raportet e punës</li> </ul>
3.2. Bashkëpunimi me Këshillin e prindërve (KP) dhe Këshillin e nxënësve (KN) në iniciativa dhe veprime konkrete për parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës në shkollë	Drejtori dhe ekipi i ndërmjetimit	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dokumenti me detyrat dhe përgjegjësitë e KP dhe KN;</li> <li>- PZSHH</li> <li>- Plani vjetor i punës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Planet e bashkëpunimit</li> <li>- Lista e pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta;</li> <li>- Raporte pune</li> </ul>
3.3. Kontrollimi i nxënësve për shmangien e mbajtjes së armëve dhe mjeteve të ndryshme të dhunës	Drejtorja e shkollës	Në vazhdimësi (varësisht nga nevojat për masa preventive)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullorja e shkollës</li> <li>- Rregullorja e DKA-s për arsim</li> <li>- Mjete të nevojshme për identifikim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plane të kontrollimit të nxënësve</li> <li>- Pyetësor me nxënës</li> <li>- Raporte të punës</li> </ul>
3.4. Identifikimi dhe raportimi i fëmijëve/nxënësve në rrezik për të shfaqur sjellje të dhunshme	Kujdestarët e klasave dhe ekipi i ndërmjetimit	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Protokoli, udhëzues dhe manual për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkollë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Instrumentet e identifikimit dhe raportimit;</li> <li>- Raporte të identifikimit</li> </ul>
3.5. Evidentimi, raportimi dhe trajtimi i rasteve me sjellje të dhunshme	Kujdestarët e klasave dhe ekipi i ndërmjetimit	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Protokoli, udhëzues dhe manual për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkollë</li> <li>- SMIA</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Instrumentet e evidentimit dhe raportimit;</li> <li>- Raporte të trajtimit të rasteve</li> <li>- Raporte me rekomandime për masat edukative të ndërmarra dhe për veprimet e mëtejme;</li> </ul>

<p>3.6. Këshillimi individual me nxënësit që kanë bërë konflikte apo sjellje agresive dhe me nxënësit që kanë qenë viktimë të konflikteve</p>	<p>Ekipi i ndërmjetësisë dhe psikologu shkollor</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Protokoli, udhëzues dhe manual për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkollë</li> <li>- Sallë/hapsirë për këshillim</li> <li>- Psikolog për këshillim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plani i këshillimeve individuale</li> <li>- Raporte të këshillimit</li> <li>- Pyetësor me nxënësit</li> </ul>
<p>3.7. Këshillimi me prindër dhe mësimdhënësit</p>	<p>Ekipi i ndërmjetësisë dhe psikologu shkollor</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Protokoli, udhëzues dhe manual për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkollë</li> <li>- Sallë/hapsirë për këshillim</li> <li>- Psikolog për këshillim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plani i këshillimeve individuale</li> <li>- Raporte të këshillimit</li> <li>- Pyetësor me prindër dhe mësimdhënësit</li> </ul>
<p>3.8. Vendosija e bashkëpunimit të organeve profesionale dhe udhëheqëse të shkollës, me institucionet komunale, organizata joqeveritare që merren me mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve për raste të ndryshme dhe që zhvillojnë programe kundër dhunës në shkollë</p>	<p>Drejtori dhe ekipi i ndërmjetësisë</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Programet e institucioneve dhe organizatave që merren me mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve për raste të ndryshme dhe që zhvillojnë programe kundër dhunës në shkollë;</li> <li>- Kontaktet e institucioneve dhe organizatave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëveshjet e bashkëpunimit</li> <li>- Planet për bashkëpunim</li> <li>- Lista të pjesëmarrjes në aktivitete të bashkëpunimit</li> <li>- Raporte të bashkëpunimit</li> <li>- Foto</li> </ul>



#### 4. Fusha e veprimt: Kapacitetet për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla

**Objekti:** Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit tjetër të shkollës për zgjidhje paqësore të konflikteve në shkolla

Aktivitetet	Bartës / përgjegjës	Afatet kohore	Burimet/ Mjetet e nevojshme	Mënyra e verifikimit/ dokumenti
4.1. Hartimi i planit për ZHPM në nivel shkollë	Drejtori dhe koordinatori i cilësisë	Cdo vit, duke filluar nga muaji gusht 2018.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- PSAK 2017-2021</li> <li>- Plani komunal për asrim</li> <li>- Planet e zhvillimit individual të mësimdhënësve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Procesverbalet e takimeve</li> <li>- Lista e pjesëmarrjes në hartimin e planit</li> <li>- Dokumenti i planit të ZHPM</li> </ul>
4.2. Hartimi i planit për ZHPM në nivel komune	DKA - Koordinator i cilësisë	Cdo vit, duke filluar nga muaji gusht 2018.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- PSAK 2017-2021</li> <li>- Planet e shkollave për ZHPM</li> <li>- Plani i zhvillimit të arsimit në nivel komune</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Procesverbalet e takimeve</li> <li>- Lista e pjesëmarrjes në hartimin e planit</li> <li>- Dokumenti i planit të ZHPM</li> </ul>
4.3. Zhvillimi/Sigurimi i materialeve për ndihmë mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe aktorëve të tjerë.	Drejtorët e shkollave	Shtator - dhjetor 2018	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Internet, pajisje të TIK-ut</li> <li>- Personel me ekspertizë në këtë fushë</li> <li>- Mjete financiare,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lista e materialeve të zhvilluara/ siguruara;</li> <li>- Raporte</li> </ul>
4.4. Organizimi i trajnimeve në nivel komunal	Koordinatori për cilësi	Në vazhdimësi - sipas planit të trajnimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Programe të trajnimit, trajner</li> <li>- Protokoli, udhëzues dhe manual për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkolla</li> <li>- Salla të trajnimit me pajisje teknike</li> <li>- Mjete financiare</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plani i trajnimeve në nivel të DKA</li> <li>- Agjenda e trajnimeve</li> <li>- Lista e pjesëmarrjes</li> <li>- Raportet e trajnimit</li> <li>- Raporti i vlerësimit të trajnimeve</li> </ul>
4.5. Organizimi i trajnimeve në nivel shkollë dhe i formave të tjera të ngritjes profesionale	Koordinatori për cilësi në shkollë	Në vazhdimësi - sipas planit të trajnimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i trajnimit, trajner në nivel shkollë</li> <li>- Protokoli, udhëzues dhe manual për parandalim dhe trajtim të rasteve të konflikteve në shkolla</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plani i trajnimeve</li> <li>- Agjenda e trajnimeve</li> <li>- Lista e pjesëmarrjes</li> <li>- Raportet e trajnimit</li> <li>- Raporti i vlerësimit të trajnimeve</li> </ul>
4.6. Krijimi i rrjetit të ekipeve të ndërmjetësimit në shkolla për shkëmbimin e përvojave pozitive	Drejtori i shkollës dhe udhëheqësi i ekipit për ndërmjetësim	Duke filluar nga tetor 2018 dhe në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëzues për krijimin e rrjetëve të bashkëpunimit</li> <li>- Kontaktet e ekipeve të ndërmjetësimit</li> <li>- Planet e ekipeve të ndërmjetësimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plani për krijimin e rrjetit</li> <li>- Agjendat e takimeve/komunikimit</li> <li>- Listat e pjesëmarrjes</li> <li>- Raporte të bashkëpunimit</li> <li>- Foto</li> </ul>

### Grupi i planifikimit

<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe mbiemri</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Pozita</b>
<b>1</b>	Suzana Gjergji	DKA	Zyrtare e Arsimit
<b>2</b>	Mevlude Murtezi	Childproof/CIPOF	Udhëheqëse
<b>3</b>	Selim Mehmeti	Childproof/CIPOF	Konsulent
<b>4</b>			



